



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

Nr. 8627 Prot.

Tiranë më, 07 / 04 / 2015

URDHËR

Nr. 02, datë 07.04.2014

Me qëllim zbatimin korrekt të legjislacionit të akcizës lidhur me lëvizjen e mallrave dhe dokumnetave shoqërues në lëvizje;

Me qëllim shmangien e abuzimeve dhe evazionit fiskal;

Bazuar në nënët 34 deri 39 të ligjit 61/2012 "Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe nenet 79 deri 88 të Vendimit të këshillit të Ministrave nr. 612, datë 05.09.2012 "Për dispozitat zbatuese të ligjit 61/2012 "Për Akcizat.."

URDHËROJ:

1. Dokumenti shoqërues Administrativ (DSHA), i përpiluar, depozituar dhe pranuar përmes sistemit informatik (modulit të akcizës) nga depozituesi i miratuar (dërgues i mallrave të akcizës), i pajisur me numrin unik ARC, duhet të mbyllet brenda kohës së përcaktuar në kutinë 17 të DSHA-së, por jo më vonë se 24 orë nga çasti i marrjes së numrit unik ARC. Me mbyllje kuptohet gjenerimi nga sistemi informatik i Raportit të Përgjithshëm për Destinacionin.
2. Asnjë mall akcize i dalë nga magazina fiskale me destinacion hedhje për konsum, nuk duhet të qarkullojë pa qënë i shoqëruara detyrimisht me DSHA (tipi 4) me akcizë të paguar (hedhje për konsum) me nr. ARC të gjeneruar si dhe Raportin e Përgjithshëm për destinacionin, të printuar nga sistemi, përmes të cilave vërtetohet pagesa e akcizës. Në rast se ky Raport i Përgjithshëm printohet pa u kryer pagesa e akcizës ndaj depozituesit të miratuar aplikohen penalitet sipas nenit 96/1 shkronja "b" të ligjit 61/2012 "Për Akcizat", të ndryshuar.
3. DSHA-të e përpiluara, depozituara dhe pranuar përmes sistemit informatik (modulit të akcizës) nga depozituesi i miratuar (dërgues i mallrave të akcizës), i pajisur me numrin

unik ARC, nga data 1 janar 2015, deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij urdhri, nuk anulohen, për shkak se janë tejkaluar kushtet për anulim të këtij dokumenti bazuar në pikën 5 të nenit 36 të ligjit 61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë” dhe lëvizja duhej të kishte përfunduar.

4. Pas datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri, DSHA- të e pranuar në sistemin elektronik, nuk mund të anulohen në rast se brenda kohës së parashikuar në pikën 2 të nenit 82, pikën 2 të nenit 83 dhe pikën 2 të nenit 87 të VKM 612/2012 “Për dispozitat e ligjit 61/2012 të Akcizës në republikën e Shqipërisë”, prej 30 minutash nuk kanë njoftuar për anulim dhe ndërprerje të lëvizjes së mallrave në pezullim. Njoftimi i kërkesës për anulim dhe arsyet përkatëse për këtë anulim, kryhet elektronikisht përmes sistemit informatik Asycuda World, brenda 30 minutave nga gjenerimi i numrit ARC të DSHA, drejt adresës elektronike të “helpdesk” dhe adresës elektronike të strukturës kopetentë për administrimin e akcizës, pranë Zyrës Doganore mbikqyrëse sipas listës bashkangjitur këtij urdhëri dhe pjesë e tij.
5. Për depozituesit e miratuar dhe pritësit e regjistruar, të cilët nuk mbyllin DSHA sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij urdhëri, aplikohen penaltet sipas nenit 96/1 të ligjit 61/2012 “Për Akcizat”, të ndryshuar.
6. Çdo ditë, Zyrat Doganore dhe sektori helpdesk (Drejtori TI) të përcjellin pranë Departamentit të Akcizës pasqyrat e listës së DSHA-ve të pambyllura në sistem, kërkesat për anulim dhe arsyet përkatëse të dhëna nga depozituesi i miratuar për këtë qëllim. Departamenti i Akcizës analizon dhe vlerëson kërkesat për anulim dhe i paraqet vlerësimin e saj Drejtorit të Përgjithshëm. Vendimi përfundimtar për anulimin e një DSHA-je merret nga Drejtori i Përgjithshëm dhe veprimet përkatëse në sistemin informatik Asycuda World bëhen nga Departamenti i Akcizës.
7. Zyrat Doganore mbikqyrëse të marrin masa për mbikqyrjen e lëvizjeve të DSHA-ve të përpiluara, depozituara dhe pranuar nga operatorët e akcizës dhe mbylljen korrekte brenda afatit të DSHA-ve.
8. Departamenti i Akcizës në DPD, ngarkohet për mbajtjen e pasqyrave për rakordimet e deklarimeve me DSHA sipas informacioneve ditore të Zyrave Doganore.
9. Struktura kompetente në DPD, të rakordojë vjeljen e të ardhurave nga deklaratimet e akcizës me DSHA në bashkëpunim me Departamentin e Akcizës dhe Departamentin Teknik sipas përcaktimeve specifike në udhëzimin “Mbi procedurën e pagesave (e-payment) të operatorëve ekonomikë, nepermjet Sistemit të Pagesave Elektronike Online, për të ardhurat Doganore, të Akcizës dhe detyrime të tjera të pagueshme në doganë, mbi menaxhimin e llogarisë parapaguese dhe mbi kontabilizimin dhe raportimin e të ardhurave doganore.”
10. Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit të sigurojë implementimin e këtij urdhri në sistemin informatik Asycuda World nëpërmjet:
 - a. Zbatimit të kërkesave të përcaktuara në pikën 3 të këtij urdhëri për kalimin e të drejtave nga Zyra Doganore tek Departamenti i Akcizës.

- b. Administrimit të sistemit informatik lidhur me kërkesat për anulim të DSHA-ve të krijuara prej tyre brenda kohës prej 30 minutash nga gjenerimi i numrit ARC të DSHA-së, sipas përcaktimevë të pikës 4 të këtij urdhëri.
 - c. Krijimit të një adrese elektronike për çdo Zyrë Doganore Mbikqyrëse përmes së cilës do të bëhet njoftimi nga operatorët e akcizës për anulimin dhe ndërprejen e lëvizjes së mallrave të akcizës sipas përcaktimeve të pikës 9 të këtij urdhëri. Kjo listë adresash respektivisht Zyrave Doganore i bashkangjitet këtij urdhëri.
11. Zyrat Doganore të marrin masa për njoftimin e menjëhershëm të operatorëve të akcizës nën mbikqyrjen e tyre territoriale lidhur me këtë urdhër si dhe përcaktimin e përdoruesve të adresës elektronike në sistemin Asycuda World, për efekte të pritjes së kërkesave të mundshme për anulim të DSHA-së.
12. Ngarkohen Zyrat Doganore, Departamenti i Akcizës, Departamenti Administrativ, Departamenti Teknik dhe Departamenti Operativ Hetimor për zbatimin e këtij urdhëri.

Ky urdhër hyn në fuqi më 7.04.2015

Irena BEQIRAJ
Irena Beqiraj
ZV. MINISTERI I FINANCËVE
DREJTOR I PËRGJITHSHËM I KOMANDUAR

